



USAID

NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



**KOSOVO LOCAL
GOVERNMENT
INSTITUTE**



KCSF

FONDACIONI KOSOVAR PER SHOQERI CIVILE
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION

RAPORTI I MONITORIMIT TË FINANCIMIT PUBLIK TË OJQ-ve NË NIVEL LOKAL PËR VITIN 2022

NËNTOR 2023

NËNTOR 2023

Programi për Angazhim Qytetar në Kosovë është një iniciativë pesëvjeçare zbatuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



**KOSOVO LOCAL
GOVERNMENT
INSTITUTE**



RAPORTI I MONITORIMIT TË FINANCIMIT PUBLIK TË OJQ-ve NË NIVEL LOKAL PËR VITIN 2022

NËNTOR 2023

Ky raport është bërë i mundur nga mbështetja bujare e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Përmbajtja:

Hyrje	3
Metodologjia	4
Kufizimet e hasura gjatë Monitorimit.....	6
Vlerësimet Individuale	7
Aspekti procedural	7
Procesi i vlerësimit dhe kontraktimi	9
Monitorimi dhe Raportimi.....	11
Monitorimet vjetore.....	12
Planifikimi i Mbështetjes Financiare	12
Mekanizmat e Zbatimit të Procesit	14
Raportimi/Monitorimi i komunave	15
Procesi i monitorimit dhe raportimit	15
Informatat e pranura nga Zyrat për Informim	17
Të gjeturat e auditorit 2022 (subvencionet e OJQ-ve).....	18
Konkluzionet.....	22
Rekomandimet.....	25

Hyrje

Ky raport ka për qëllim të pasqyrojë progresin në përmbushjen e indikatorëve matës nga monitorimi i zbatimit të 'Rregullores nr. 04/2017, mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të Organizatave Jo-Qeveritare (OJQ)' ¹ në nivel lokal. Raporti ndjek kronologjinë e obligimeve të Rregullores dhe zbatimin e tyre nga komunat në proceset e financimit publik për OJQ-të.

Raporti përfshin informata nga monitorimi i 56 thirrjeve të publikuara nga 26 komuna (tabela me informatat e thirrjeve të monitoruara për komunë në Shtojcën 1). Edhe pse për këtë proces janë planifikuar të monitorohen 38 komuna, shtatë prej tyre ² nuk kanë raportuar se kanë pasur thirrje, përjashtuar komunën e Pejës, edhe pse nuk ka raportuar në planifikim, ka pasur thirrje; pesë komuna ³ kanë deklaruar se nuk kanë pasur financim për OJQ-të, përfshirë këtu komunën e Junikut që ka raportuar, nuk është gjetur thirrja por vetëm të dhënat e hollësishme në bazë të të dhënave për financimin e OJQ-ve në Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit (ZQM/ZK).

Nga komunat për të cilat janë siguruar të dhënat për të gjitha kriteret e monitoruara, nga vlerësimet individuale (thirrjet nga ofruesit e mbështetjes financiare), zbatueshmëria më e lartë e arritur është 57 prej 70 kriterëve apo (81.43%) ndërsa zbatueshmëria më e ulët 14 nga 70 kriterë apo (27.14%). Nga vlerësimet vjetore (planifikimi, zbatimi dhe raportimi), prej 62 kriterëve të vlerësuar, arritja më e lartë është 35 nga 62 kriterë apo (56%) dhe niveli më i ulët i përmbushjes del, 1 kriter nga 62 apo (2%).

Sipas obligimeve të ndara, të dhënat e përmbledhura tregojnë se: nga 43 përgjegjësitë që i takojnë ofruesit të mbështetjes financiare, arritja më e lartë është zbatimi i 25 përgjegjësive apo (58%) dhe më e ulët është 1 (2%); Ministria e financave, edhe pse ka vetëm një detyrë, nga 19 komunat që kanë paraqitur planifikim për vitin 2022, 14 komuna kanë paraqitur kodet buxhetore, pesë nuk kanë paraqitur; nga 15 detyrat e Zyrtarit Kryesor Administrative (Kryetari i Komunës), arritja më e lartë është zbatimi i 14 prej tyre (93%); Në 17 komuna nga 19 gjithsej, koordinatorët kanë paraqitur raportet në ZQM; Koordinimi me Zyrën e Qeverisjes së Mirë/Zyra e Kryeministrit, arritja më e lartë del 3 (75%).

Nga procesi i monitorimit janë nxjerrë gjetje të përgjithshme, të ndërthurura dhe specifike. *Të parat*, përgjithësisht shërbejnë për vendimmarrësit në përmirësimin e proceseve dhe mekanizmave sa i përket financimit publik të OJQ-ve; *të dytat* ndihmojnë ofruesit e mbështetjes financiare që t'i përmirësojnë aspektet që ndikojnë direkt ose tërthorazi në procesin e financimit publik të OJQ-ve dhe *të fundit* vlejné kryesisht për zbatuesit në përmirësimin e fushave specifike të financimit publik të OJQ-ve në nivel lokal. Sikurse për monitoruesit, ashtu edhe për zyrtarët komunalë, të gjeturat e raportit kanë për qëllim përmirësimin e fushave specifike nëpërmjet metodologjisë së monitorimit të financimit publik të OJQ-ve.

Raporti në vijim është i ndarë në tri pjesë kyçe: 1. Të gjeturat nga monitorimet individuale (secili proces i financimit); 2. Të gjeturat nga monitorimet vjetore (për komunë); dhe 3. Thekset nga raportet vjetore (2022) të auditorit. Prezantimi në dy pjesët e para është i strukturuar në monitorimin individual (thirrjet veç e veç) përfshirë procesin teknik, aspektet e vlerësimit, raportimit dhe monitorimit. Pjesa e tretë trajton monitorimin vjetor (procesin e përgjithshëm) përfshirë planifikimin, mekanizmat, monitorimin,

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=14831>

² Deçan, Partesh, Pejë, Shtërpcë, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë Veriore

³ Leposaviç, Mamushë, Kllokot, Hani i Elezit dhe Ranillug

dhe raportimin vjetor. Pjesa e katërt pasqyron gjetjet kryesore të raporteve të auditimit. Raporti përmbillet me konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse të këtij procesi.

Raporti është hartuar në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar (CEA), i cili program përkrahë aktivitete të shumta të cilat synojnë përmirësimin e lidhjes së shoqërisë civile me qytetarë, bashkëpunimin brenda sektorit dhe me sektorë të tjerë, si dhe diversifikimin e burimeve të shoqërisë civile përtej fondeve të donatorëve të huaj me qëllim të fuqizimit të pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies të institucioneve publike dhe të OShC-ve ndaj publikut. Programi për Angazhim Qytetar në Kosovë është një iniciativë pesë vjeçare zbatuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). KLGI është partner i KCSF-së në realizimin e këtij aktiviteti.

Metodologjia

Duke u bazuar në metodologjinë e suksesshme ekzistuese të monitorimit mbi konsultimet publike në nivel qendror, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) dhe Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGI) kanë zhvilluar një metodologji monitorimi të përshtatur që synon të monitorojë dhe raportojë për gjithëpërfshirjen dhe transparencën e vendimmarrjes në nivel lokal.

Metodologjia nënkupton ekstraktimin e treguesve të monitorimit të organizuar në kategori nga dispozitat e parashikuara në Udhëzimin Administrativ 06/2008 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna⁴, si dhe sqarimet/interpretimet në Doracakun për Konsultim Publik në Komuna⁵. Kategoritë grupojnë fusha të caktuara të ndërlidhura në formë logjike, të ndara në nën-kategori.

Kategoritë dhe procesi i financimit publik të OJQ-ve ndahen në dy grupe:

- Grupi i parë – monitorimet individuale (Procesi i Financimit të Organizatave Jo-Qeveritare);
- Grupi i dytë – monitorimi vjetor (Planifikimi i procesit; Monitorimit dhe Raportimi).

Monitorimi është zbatuar në dy rrafshë: i. Procesin e financimit dhe ii. Procesin e planifikimit, monitorimit dhe raportimit dhe janë gjeneruar të dhëna specifike për komunat përkatëse. Mjetet e monitorimit, nëpërmjet treguesve, u mundësojnë palëve (institucioneve dhe organizatave monitoruese), qasje pro-aktive dhe komunikim dy-kahor:

- Individët, organizatat, nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm dhe uniform ofrojnë pasqyrim të strukturuar të procesit;
- Komunat identifikojnë mangësitë përgjatë procesit të tërësishëm të financimit publik të OJQ-ve.

Gjatë periudhës njëmuajore (12 qershor – 12 korrik) kur është realizuar monitorimi, janë gjeneruar 19 raporte vjetore, apo nga një raport për secilën komunë që kanë paraqitur planifikim në OJQfinancime⁶, janë kontaktuar 26 Zyra për Informim të Komunave dhe janë pranuar 15 formularë me përgjigje. Monitorimi ka përfshirë edhe krahasimin me raportin vjetor 2022⁷ dhe është realizuar nga Instituti

⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18425>

⁵ <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/06/FINALEE-Manuali-ne-tri-gjuhet-1.pdf>

⁶ <http://ojqfinancime.rks-gov.net/>

⁷ <http://ojqfinancime.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/07/RaportiVjetor2022.pdf>

Kosovar për Qeverisje Lokale (KLG) me ndihmën e OJQ-ve lokale të cilat janë përzgjedhur përmes thirrjes së hapur për angazhim dhe një aktivisti të pavarur.

Bashkëpunëtorët e përfshirë janë:

- Rrjeti i OJQ-ve Lokale Demokracia Fillon (rrjeti DFK) Këtu që ka monitoruar komunat: Podujevë, Prishtinë, Obiliq;
- Center for Education and Development of Environment (CEDE) që ka monitoruar komunat: Fushë Kosovë, Lipjan, Glllogoc;
- Organizata për Hulumtime Ekonomike dhe Sociale OHES që ka monitoruar komunat: Suharekë dhe Malishevë;
- Fisnik Egër, pjesëmarrës në Akademinë për udhëheqësi në komunitet organizuar nga CEA ka monitoruar komunat: Prizren, Dragash dhe Mamushë;
- OJQ ACCESS ka monitoruar komunën e Vushtrrisë;
- Center for Education and Community Development- friends (CECD - friends) ka monitoruar komunat: Mitrovicë e Jugut dhe Skenderaj;
- Network of Peace Movement (NOPM) ka monitoruar komunat: Kamenicë, Ranillug, Partesh dhe Novobërdë;
- Organizata ZANA ka monitoruar komunën e Klinës;
- Organizata Lions International-Lions Club Peja ka monitoruar komunat: Pejë dhe Istog;
- Organizata Politeia ka monitoruar komunat: Gjilan, Viti, Klllokot dhe Graçanicë, si dhe
- Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLG) është angazhuar në monitorimin e komunave: Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Hani i Elezit, Shtërpçë, Gjakovë, Junik, Rahovec, Deçan, Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan.

Ekipi i Institutit KLG ka analizuar edhe të dhënat e pranuar përmes pyetësorëve dhe pas përmbylljes së monitorimit ka organizuar punëtori me Zyrtarët Kryesorë Financiarë (ZKF) të tetë komuna, ku janë validuar gjetjet. Të dhënat e përgjithshme të këtij procesi janë krahasuar edhe me raportet tjera, sikurse Procesi i Buxhetimit në Komuna, ku janë nxjerrë të dhëna për përfshirjen e OJQ-ve dhe grupeve të interesit në procesin e dëgjimeve buxhetore (planifikimin) e financimit publik. Po ashtu, janë nxjerrë informatat kryesore nga raportet e auditimit për vitin 2022, në fushën e subvencionit, me fokus financimin publik të OJQ-ve. Përgjatë analizës së të dhënave, janë nxjerrë në pah mangësitë nga secila fushë veç e veç.

Kufizimet e hasura gjatë Monitorimit

Përgjatë monitorimit janë hasur një seri e kufizimeve ku të grupuara dalin:

1. Kufizimet në monitorim teknik (qasja në ueb-faqe dhe mungesa e seksioneve të veçanta për subvencionet e OJQ-ve);
2. Kufizimet operacionale të zbatimit të financimit të OJQ-ve (financimi nëpërmjet subvencionimit të shërbimeve si ato të varrimit, shërbimeve sociale, anëtarësisë pa thirrje publike edhe pse përftuesit kanë statusin e OJQ-ve);
3. Kufizimet në praktika (Instituti KLG dhe OJQ-të lokale po përdorin për herë të parë metodologjinë e monitorimit të financimit publik të OJQ-ve në nivel lokal, andaj ka mjete, praktika të reja; njëkohësisht edhe për komunat është mjet i ri i vetëvlerësimit);

4. Kufizimet në monitorim të planifikimit (është dashur të përdoren mjete rrethore/raporte për të evidentuar konsultimin e komunave me OJQ-të, përfshirë edhe monitorimin e vendosjes së objektivave të thirrjeve, në mungesë të referencës së strategjive apo planeve lokale nga dalin ato);
5. Kufizimet në monitorimin e vlerësimit dhe trajtimit të brendshëm në komuna (mospublikimi i procesverbaleve nga komisioni vlerësues/apo edhe formave të vlerësimit dhe procesverbalet e trajtimit të ankesave);
6. Qasja e kufizuar në vlerësimin (mungesa e raporteve të përmbledhura bashkë me nivelin e zbatimit, monitorimin dhe raportimin e projekteve);
7. Kufizimet në koordinimin e brendshëm komunal (në mes zyrave për informim në publikim - ofruesit të mbështetjes në qasjen pro aktive të ofrimit të informacionit - raporteve, procesverbaleve për zyrat e informimit dhe zyrtarët kryesorë financiarë për pagesat).

Vlerësimet Individuale

Aspekti procedural

Kriteret e shpalljes publike të thirrjes⁸

Në përgjithësi të dhënat e thirrjeve publike janë të shpërndara në ueb-faqet e komunave dhe nuk ekziston një strukturë unike. Referuar aspektit procedural, duhet theksuar se ekziston një kategori e subvencionimit që në planifikim trajtohet si financim i OJQ-ve, por që në realitet ka karakteristika të ofrimit të shërbimeve siç janë: shërbimet sociale, shpenzimet e varrimit apo pagesat e anëtarësisë. Të tilla janë pagesat e shpenzimeve specifike si dhe financimi i aktiviteteve për grupe apo kategori të veçanta të cilat nuk duhet trajtuar njësoj.

Në kategorinë e shpalljes publike të thirrjes janë monitoruar gjashtë kritere. Konkretisht, nga 56 thirrje të monitoruara, në pyetjen se a është publikuar thirrja në ueb faqen e komunës, 97% kanë deklaruar se kanë publikuar thirrjen, një prej tyre është anuluar dhe një thirrje nuk ishte e qasshme në ueb faqen e komunës. Sa i përket përdorimit të formave tjera të informimit për rritjen e konkurrueshmërisë, përfshirë platformën OJQ-financime, rrjetet sociale, apo takime publike informuese, të dhënat tregojnë se edhe pse në 66% të rasteve janë përdorë edhe forma tjera të informimit, asnjëra nga komunat nuk kanë publikuar thirrjen në platformën e financimit publik të OJQ-ve. Këtu vlen të theksohet se ka dallim të thirrjet e fondeve që menaxhohen nga vet komunat dhe atyre të bashkë-financuara, ku përtej publikimit, për këto thirrje organizohen edhe takime informuese. Një tjetër vërejtje e rëndësishme është se disa prej organizatave, shpesh edhe përfaqësuese të grupeve të cenuara, diskualifikohen për mungesë dokumentacioni si pasojë e mungesës së informimit apo asistencës teknike.

Në pyetjen se a është mbajtur e hapur thirrja së paku 15 ditë pune, në katër raste nuk është respektuar ky afat, ndërsa në gjashtë raste është tejkaluar. Në indikatorin e vlerësimit të mundësisë për sqarime shtesë përmes postës elektronike (e-mail), përafërsisht gjysma kanë ofruar këtë mundësi, ndërsa gjysma tjetër nuk kanë vendosur e-mail kontakt në thirrje. Tutje, në pyetjen se a janë ofruar sqarime dhe përgjigje me shkrim dhe a janë publikuar të njëjtat në ueb faqe së paku tetë ditë para mbylljes së thirrjes, del se vetëm për pesë thirrje ku është dhënë mundësia për sqarime, janë ofruar sqarime dhe përgjigje me shkrim si dhe të njëjtat janë publikuar në ueb faqe.

Sa i përket performancës së komunave në këtë kategori, të dhënat tregojnë se 65% e komunave kanë zbatuar më shumë se tre indikatorë.

Kriteret e thirrjes publike dhe dokumentacioni i kërkuar⁹

Kjo fushë përfshinë indikatorët që vlerësojnë strukturën e thirrjes, përfshirë dokumentet përcjellëse si: udhëzimin, formularin për shkrimin e projektit/programit, formularin për buxhet, listën e dokumenteve të kërkuara, datën e hapjes dhe mbylljes së thirrjes, mënyrën e dorëzimit të aplikacioneve.

Nga të dhënat e monitorimit del se 95% e thirrjeve të publikuara kanë përfshirë udhëzimet për aplikantët, përfshirë kriteret përzgjedhëse. Sa i përket formularëve, në 68% të rasteve formulari për përshkrimin e projektit/programit ka qenë pjesë e thirrjes, ndërsa në 88% të rasteve thirrjet kanë pasur formularin për buxhet. Lista e dokumenteve të kërkuara ka qenë pjesë e 79% të thirrjeve të publikuara, ndërsa 95% e

⁸ Referuar Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Neni 12 (12.1-12.4)

⁹ Neni 13 (1.1 – 1.5)

tyre kanë specifikuar afatin për aplikim. Indikatori i fundit i monitoruar në këtë kategori ka të bëjë me udhëzimet për mënyrën e aplikimit/dorëzimit të aplikacioneve që nuk ka qenë e përfshirë në vetëm një prej thirrjeve të monitoruara. Të dhënat dëshmojnë se 69% e komunave ku janë monitoruar thirrjet e publikuara kanë treguar performancë të plotë në të gjithë indikatorët e kësaj kategorie.

Përmbajtja e udhëzimeve për aplikantët¹⁰

Pas vlerësimit të kriterëve të thirrjes dhe dokumentacionit të kërkuar, janë vlerësuar 22 indikatorë rreth përfshirjes së udhëzimeve për aplikantët në thirrjet e publikuara. Nga monitorimi i realizuar del se informatat mbi organizatat që kualifikohen kanë qenë më së shpeshti të përfshira në thirrje (mesatarja e përfshirjes 99%), vijuar nga 98% që kanë paraqitur adresën dhe mënyrën për dorëzim dhe 96% ku është paraqitur data e hapjes dhe mbylljes së thirrjes. Tabela në vijim paraqet renditjen e indikatorëve duke filluar nga ato me mesatare më të lartë të përfshirjes në thirrje.

Indikatorët që vlerësojnë përfshirjen e udhëzimeve për aplikantët në thirrjet e publikuara	Mesatarja e përfshirjes në thirrje
Organizatat që kualifikohen	99%
Paraqitja e adresës	98%
Data e hapjes/mbylljes	96%
Përshkrimi i fushave	91%
Dokumentacioni i detyrueshëm dhe jo të detyrueshme për aplikim	90%
Shumat më të ulëta/ larta - numri i projekteve	86%
Objektivat e thirrjes	81%
Kushtet dhe mënyra e parashtrimit të pyetjeve	80%
Shuma e mjeteve financiare	78%
Përshkrimi i problemit	73%
Parimet prioritare	71%
Kohëzgjatja	71%
Aktivitetet e kualifikuara	71%
Paraqitja e kalendarit tentativë për zbatimin të procedurës së thirrjes	66%
Kushtet dhe mënyra e paraqitjes së ankesave	64%
Shpenzimet e pranueshme/të pa pranueshme	62%
Informacioni mbi kontraktimin	51%
Numri i përafërt i kontratave	26%
Procedura për monitorim si dhe metoda dhe përmbajtja e raportimit	21%
Mënyra e publikimit të përgjigjeve	15%
Mundësia për ndryshimenga aplikantët	4%
Korrigjimet e thirrjeve	1%

¹⁰ Neni 14 (2.1 - 2.19, 3, 4)

Mënyra e Aplikimit¹¹

Në këtë kategori fokusi ka qenë te vlerësimi se sa prej thirrjeve mundësojnë aplikimin përmes postës elektronike (e-mail). Referuar manualit për implementimin e rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit të OJQ-ve, kufizon përdorimin e regjistrave digjitalë, vetëm në aplikimin fizik në regjistrimin e protokollit fizik në zyrat pritëse. Kjo, edhe si rezultat se rregullorja për financim të OJQ-ve e kufizon vetëm aplikimin me zarfe dhe një kopje elektronike në CD¹².

Nga thirrjet e monitoruara del se adresa për dorëzimin e aplikacionit, me përjashtim të vetëm një rasti, në të gjitha rastet tjera është publikuar në thirrje dhe ka figuruar edhe afati për pranim të aplikacioneve. Sa i përket mënyrave të aplikimit, aplikimi përmes emailit është lejuar në po aq raste sa edhe mundësia për aplikim vetëm përmes kopjeve fizike dhe USB (23 raste secila dhe 10 raste ku mungojnë të dhënat), ndërsa aplikimi në platforma elektronike është lejuar në vetëm 23% të rasteve (si mundësi shtesë pas aplikimit fizik). Në pjesën më të madhe të thirrjeve (84%) ka qenë i përcaktuar formati dhe dokumentacioni për aplikim.

Procesi i vlerësimit dhe kontraktimi

Vlerësimi i aplikacioneve nga aspekti procedural¹³

Në këtë fushë është vlerësuar procesi i punës nga komisioni vlerësues, ku monitoruesit janë udhëzuar të marrin të dhëna në dy forma: e para, të kërkojnë informata se a është publikuar procesverbali i komisionit vlerësues në ueb faqen e komunës përkatëse, dhe e dyta, të verifikohet e dhëna nëpërmjet Zyrës për Informim.

Sa i përket vlerësimit të aplikacioneve nga aspekti procedural, nga 56 thirrjet e publikuara në 26 komuna, vetëm në tri komuna monitoruesit kanë raportuar se janë gjetur të dhëna mbi procesin e vlerësimit, dhe po në tri komuna janë gjetur të dhëna se vlerësimi i aplikacioneve ka ndodhur brenda pesë ditëve nga mbyllja e thirrjes. Të dhënat se a i kanë plotësuar aplikacionet e pranuar kriteret e përgjithshme janë gjetur vetëm për gjashtë thirrje.

Vlerësimi përmbajtjesor¹⁴

Kjo fushë është vlerësuar nëpërmjet dy formave: 1. monitoruesit janë udhëzuar që të gjejnë procesverbalin e Komisionit Vlerësues dhe 2. në mungesë të tij, disa nga fushat t'i krahasojnë mes rezultateve preliminare dhe përfundimtare të thirrjeve.

Nga monitorimi del se vetëm në shtatë thirrje është përdorë poentimi deri 100 pikë; Në gjashtë raste është paraqitur lista e aplikantëve të diskualifikuar nën pragun 50 pikë.

Sa i përket publikimit të listave, në gjashtë thirrje ka pasur më tepër të listuar sesa numri i përfituesve dhe janë renditur sipas pikëve ndërsa në tri thirrje nuk janë renditur sipas pikëve. Është evidentuar se në disa raste rezultatet janë publikuar vetëm sipas numrit të protokollit.

¹¹ Neni 15 (1 – 4)

¹² Neni 15 (1)

¹³ Neni 17 (1 -2)

¹⁴ Neni 18 (3, 4, 6)

Kërkesat për dëshmi të Komisionit Vlerësues për aplikuesit e përzgjedhur¹⁵

Informatat për këtë fushë të vlerësimit janë siguruar përmes procesverbaleve të komisioneve vlerësuese të publikuara në ueb faqet e komunave si dhe duke i konfirmuar me Zyrat për Informim. Në mungesë të procesverbaleve të dhënat janë vlerësuar edhe nga publikimi i thirrjes dhe udhëzimit për aplikim. Dokumentet për të cilat sipas rregullores, Komisioni Vlerësues duhet të kërkojë dëshmi janë: Dokumentet mbi obligimet tatimore (kërkuar në 63% të rasteve), Statusin e përfitimit publik (34% të rasteve), Dëshmi se OJQ-të nuk janë në procedurë të shuarjes (20% të rasteve); Dëshmi se nuk janë në procedurë të çregjistrimit (20% të rasteve) dhe deklarata vjetore tatimore (26% të rasteve).

Në këtë kategori janë vlerësuar edhe rastet kur aplikacionet me më së shumti pikë që kanë mbetur jashtë listës paraprake janë marrë parasysh (vetëm dy raste), ndërsa në 41% të thirrjeve të monitoruara shpallja e rezultateve përfundimtare është bërë pas përmbylljes së afatit të ankesave.

Afatet dhe procedurat e shqyrtimit të ankesave¹⁶

Për këtë fushë monitoruesit janë udhëzuar të nxjerrin të dhëna nga procesverbali i Komisionit të Ankesave në ueb faqet e komunave dhe t'i konfirmojnë ato me Zyrat Komunale për Informim. Sipas të dhënave, del se nga 26 komunat që kanë hapur thirrje, vetëm në pesë prej tyre janë gjetur procesverbalet e Komisionit të Ankesave. Rrjedhimisht këto komuna rezultojnë me përmbylljen më të lartë të kriteve të përfshira në këtë fushë.

Në pesë rastet e evidentuara, del se nuk ka pasur ndonjë ankesë ndaj vendimit për diskualifikim për shkak të mos përmbylljes së kriteve formale; në katër raste janë evidentuar ankesa ndaj vendimit për mos ofrimin e mbështetjes financiare, në të pesë rastet komisioni ka marrë vendim brenda pesë ditëve nga data e pranimit të ankesës dhe po në të gjitha rastet edhe ka njoftuar palët për vendimin.

Sikurse në fushën paraprake të vlerësimit edhe këtu është evidentuar mungesë e të dhënave në numër të konsiderueshëm të rasteve.

Kontrata me përfituesin¹⁷

Fusha e fundit e monitoruar në kategorinë e procesit të vlerësimit dhe kontraktimit ka të bëjë me indikatorë që ndërlidhen me këtë proces. Këtu monitoruesit janë udhëzuar të gjejnë informatat në ueb faqet e komunave dhe disa të dhëna janë udhëzuar t'i vrojtojnë përmes udhëzuesit për aplikim. Pas kësaj, monitoruesit janë kyçur në platformën OJQ-financime ku kanë analizuar tabelën e të dhënave të hollësishme sipas formularit për informatat e mbështetjes së financimit publik të OJQ-ve (f20)¹⁸ dhe bazën e të dhënave në platformën OJQfinancime¹⁹.

Të dhënat e kësaj fushe paraqesin informata mbi strukturat e kontratave duke përfshirë:

- i. Respektimin e afatit prej 90 ditësh të lidhjes së kontratës nga data e mbylljes së thirrjes publike;

¹⁵ Neni 20 (3.1 – 3.4, 4, 5)

¹⁶ Neni 21 (1.1 -1.2, 3, 6, 7)

¹⁷ Neni 22 (1, 2.1 – 2.7)

¹⁸ https://view.officeapps.live.com/office/view.aspx?src=http%3A%2F%2Fojqfinancime.rks-gov.net%2Fwp-content%2Fuploads%2F2022%2F02%2FF20_Formulari_SQ-1.xlsx&wdOrigin=BROWSELINK

¹⁹ [Baza e të dhënave e financimit të OJQ-ve – Mbështetja Financiare Publike për OJQ \(rks-gov.net\)](#)

- ii. Detajet lidhur me shumën e financimit, periudhën e zbatimit, monitorimin e zbatimit dhe raportimin për projektin e përfituesit;
- iii. Dispozitat ku përcaktohet qëllimi i mbështetjes financiare dhe ndalimi i përdorimit të mjeteve për qëllime tjera;
- iv. Dispozitat që obligojnë përfituesit që mjetet nga mbështetja financiare t'i shpenzojnë përmes transaksioneve bankare në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- v. Dispozita me të cilat tregohet mënyra dhe afatet e pagesës duke përfshirë shumën e paradhënies;
- vi. Dispozita me të cilat shmanget konflikti i interesit gjatë shpenzimit të mjeteve nga mbështetja financiare;
- vii. Dispozita lidhur me rastet kur mund të shkëputet kontrata, dhe
- viii. Dispozita me të cilat rregullohet kthimi i mjeteve në rast të shkëputjes së kontratës.

Në përgjithësi të dhënat dëshmojnë zbatim të ulët të dispozitave të lartcekura. Konkretisht, dispozita mbi shkëputjen e kontratës është paraqitur në vetëm nëntë thirrje të monitoruara; i. afati për lidhjen e kontratës është respektuar në tetë thirrje, ndërsa dispozitat e tjera, përjashtuar ii. detajet lidhur me shumën e financimit, periudhën e zbatimit, monitorimin e zbatimit dhe raportimin për projektin e përfituesit e hasur vetëm në një thirrje.

Monitorimi dhe Raportimi

Monitorimi dhe raportimi i projekteve/programeve²⁰

Të dhënat për këtë fushë janë siguruar përmes raporteve përmbledhëse të ofruesit të mbështetjes financiare publikuar në ueb faqet e komunave, në bazën e të dhënave krahasuar mes tabelës dhe f2o, si dhe raportit gjithëpërfshirës vjetor²¹. Kjo fushë, merr parasysh edhe të dhënat nga monitorimi vjetor, në veçanti tek pjesa e themelimit të ekipit monitorues, përgatitjes së planifikimit dhe raportimit, përfshirë edhe platformën OJOfinancime.

Informatat e hasura për këtë fushë dëshmojnë përgjithësisht zbatim të ulët. Specifikisht, vetëm për tetë thirrje është gjetur se është caktuar zyrtar përgjegjës që duhet të monitoroj zbatimin e projektit dhe vetëm në pesë thirrje evidentohet raportimi tek ekipi monitorues në baza të rregullta, në raste tjera nuk ka të dhëna. Performancë më e mirë është evidentuar në zbatimin e kontratës ku në 37% të thirrjeve nuk janë evidentuar shkelje në zbatimin e saj. Për thirrjet e tjera vlen të përmendet se në shumicën e rasteve të dhënat kanë munguar.

Ndërkaq, në fushën e raportimit janë evidentuar këto të dhëna: vetëm në dy nga thirrjet e monitoruara zyrtari/ekipi monitorues ka raportuar tek zyrtari kryesor administrativ, në 39% të thirrjeve tregohet se nuk ka pasur shkëputje të kontratave për shkak të shkeljeve të rënda; për 28% të thirrjeve nuk është nxjerrë vendimi për anulimin e kontratës dhe vetëm në dy thirrje është paraparë masa për iniciimin e procedurave gjyqësore përkatëse.

Sikurse në indikatorët e monitorimit edhe këtu vlen të ceket se për pjesën e mbetur të thirrjeve në shumicën e rasteve nuk janë gjetur të dhëna.

²⁰ Neni 23 (1 -4)

²¹ <http://ojqfinancime.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/07/RaportiVjetor2022.pdf>.

Monitorimet vjetore

Monitorimi i raporteve vjetore të Rregullores për Financim Publik të OJQ-ve, paraqet hartëzimin e procesit të financimit nisur nga: planifikimi, zbatimi, monitorimi dhe raportimi. Ky monitorim u ofron palëve një pasqyrë të gjerë mbi hallkat e dobëta të procesit: 1. Nivelin e përgatitjes teknike dhe procedurale për procesin e financimit; 2. Nivelin e zbatimit të rregullores për financim; 3. Nivelin (vjetor) të planifikimit, monitorimit dhe raportimit të financimit. Rrjedhimisht, përveç monitorimit të performancës vjetore, ky monitorim merr parasysh edhe kapacitetet zbatuese. Në këtë pjesë janë monitoruar 19 nga 38 komuna meqë pjesa tjetër nuk kanë paraqitur planifikim.

Planifikimi i Mbështetjes Financiare

Planifikimi i mbështetjes financiare²²

Në këtë fushë monitoruesit janë udhëzuar të përcjellin planin vjetor të financimit në komuna nëpërmjet ueb faqeve, e në rastet kur ky plan nuk është paraqitur në ueb faqe, është marrë parasysh vlerësimi i programimit në planin vjetor të mbështetjes financiare në OJQfinancime. Po ashtu, gjatë hartimit të raportit për të siguruar të dhëna, janë kryer disa krahasime mes të dhënave nga raportet relevante sikurse planifikimi i financimit nga konsultimet me OShC-të ku janë nxjerrë të dhëna nga dëgjimet buxhetore në komuna sipas grupeve të interesit.

Referuar të dhënave nga plani vjetor i mbështetjes financiare, 19 nga 38²³ komuna nuk kanë paraqitur planifikim. Nga raporti i Proceseve Buxhetore në Komuna 2022²⁴ del se 12 komuna kanë mbajtur dëgjime buxhetore me grupe të interesit (të rinjtë, sporti, kultura, shoqatat e grave, organizata të grupeve të margjinalizuara) ose OJQ.

Këtu të dhënat janë nxjerrë sipas komunave, po ashtu, të ndara edhe sipas obligimeve të institucioneve përgjegjëse. Fushat e monitoruara janë: kodet e veçanta ekonomike, planifikimi i mbështetjes financiare dhe konsultimet me OJQ-të.

Në këtë fushë monitoruesit kanë siguruar të dhëna për të gjitha komunat që kanë paraqitur plan vjetor, dhe është krijuar kod i veçantë ekonomik për organizatën buxhetore nga Ministria e Financave.

Të dhënat e monitoruara tregojnë se të gjitha komunat (19 gjithsejtë) kanë plotësuar kushtet për të ofruar mbështetje financiare për OJQ-të (krijimi i kodit dhe planifikimi i mbështetjes financiare dhe konsultimi me OShC-të); prej të cilave 84% kanë planifikuar mbështetje financiare në kuadër të buxhetit vjetor në linjë me objektivat strategjike dhe në konsultim me shoqërinë civile.

Plani vjetor i mbështetjes financiare²⁵

Në këtë fushë monitoruesit janë udhëzuar të shohin nëse është përgatitur plani vjetor brenda afateve dhe se a i ka përmbajtur të dhënat sipas kërkesës së rregullores për financimin publik të OJQ-ve. Të dhënat janë nxjerrë nga planifikimi vjetor në komuna (ueb faqe) në rast se ato nuk janë gjetur nga planifikimi vjetor në OJQfinancime.

²² Neni 5 (3, 1, 4)

²³ http://ojqfinancime.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/02/Plani_Vjetor_i_financimit_te_OJQ-ve_2022_update2022-02-23.pdf

²⁴ lqi-ks.com/wp-content/uploads/2023/04/Analiza-e-Proceseve-Buxhetore-Komunale-2023.pdf

²⁵ Neni 6 (1,2, 1.1 – 1.7, 3, 2))

Të dhënat e siguruara për këtë fushë tregojnë se:

- Afati për të përgatitur planin vjetor të mbështetjes financiare (30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor) është respektuar në tetë komuna;
- Në 15 komuna janë gjetur informata për organizatën buxhetore në planin vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të;
- Pesë komuna kanë publikuar pjesën e vetë të planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 45 ditë pas miratimit të buxhetit;
- Për 13 komuna është përgatitur plani përmbledhës vjetor i mbështetjes financiare për OJQ-të, më së largu pas 45 ditëve pas miratimit të buxhetit të Republikës së Kosovës nga Zyra e Kryeministrit; dhe
- Për 10 komuna është publikuar nga ZQM plani përmbledhës vjetor i mbështetjes financiare për OJQ-të në faqen e saj elektronike.

Ndërkaq, lidhur me përmbajtjen e të dhënave nga plani vjetor del se 84% e komunave (16 prej 19):

- Kanë përfshirë shumën e mbështetjes financiare për vitin fiskal;
- Kanë përfshirë fushat e parapara për mbështetje financiare për OJQ;
- Kanë përfshirë në planin vjetor kohën e hapjes së thirrjes për aplikime; dhe
- Janë gjetur informata për organizatën buxhetore në planin vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të.

Ndërsa, 15 komuna kanë paraqitur objektivat e mbështetjes financiare në planin vjetor; dhe 14 prej tyre kanë paraqitur në planin vjetor të financimit të OJQ-ve numrin e përafërt të organizatave që do të përfitojnë nga financimi dhe kohën e përafërt të fillimit të zbatimit të projekteve/programëve përfituese.

Mekanizmat e Zbatimit të Procesit

Komisioni Vlerësues²⁶

Në këtë fushë monitoruesit janë udhëzuar të gjejnë vendimin për komisionin vlerësues, në rast se kjo e dhënë nuk është siguruar, atëherë një pjesë e të dhënave janë udhëzuar të nxirren nga thirrja për aplikim, lista preliminare dhe përfundimtare. Informatat e nxjerra këtu përfshijnë përbërjen, kohëzgjatjen dhe mandatin e komisionit vlerësues (sipas vendimit nga Zyrtari Kryesor Administrativ - ZKA).

Gjetjet në këtë fushë tregojnë se:

- Vetëm në gjashtë komuna: i. është përcaktuar përbërja, kohëzgjatja dhe mandati i komisionit, me vendim të ZKA-së dhe ii. anëtarët janë zgjedhur përmes thirrjes publike të shpallur nga ofruesi i mbështetjes financiare;
- Vetëm në pesë komuna: i. Komisioni Vlerësues është themeluar gjatë kohës sa thirrja publike ka qenë e hapur; ii. në Komision është përfshirë një përfaqësues nga njësia përkatëse, në kuadër të të cilës është planifikuar mbështetja financiare dhe iii. njëri nga anëtarët është përfaqësues i OJQ-ve;

²⁶ Neni 8 (2, 3, 3.1 -3.3, 5, 6, 7)

- Vetëm në katër komuna: i. janë përfshirë dy përfaqësues nga institucioni që ofron mbështetjen financiare, njëri nga të cilët është nga njësia përkatëse për buxhet/financa dhe ii. janë bërë publik emrat e anëtarëve të Komisionit Vlerësues brenda shtatë (7) ditëve pas themelimit të Komisionit;
- Vetëm në tri komuna janë përfshirë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm; dhe
- Vetëm në dy komuna: i. ZKA është siguruar se në proces nuk ka anëtarë të komisionit të emëruar politikë; ii. në mbledhjen e parë Komisioni Vlerësues i ka miratuar rregullat e punës që udhëheqin punën në komision dhe janë bërë publike rregullat e punës brenda shtatë ditëve pas miratimit.

Për rastet tjera kryesisht mungojnë të dhënat.

Komisioni i Ankesave²⁷

Në këtë fushë monitoruesit janë udhëzuar të gjejnë vendimin për komisionin e ankesave e në rastet kur kjo e dhënë nuk është siguruar, një pjesë e të dhënave janë siguruar nga listat preliminare dhe përfundimtare të përfituesve.

Të dhënat tregojnë se nga 19 komunat e monitoruara:

- 53% (10 komuna) kanë themeluar Komisionin e Ankesave;
- Shtatë komisione: i. janë përbërë nga tre anëtarë dhe kanë pasur mandat dy vjeçar; ii. është parandaluar përfshirja e të emëruarve politikë dhe iii. përbërja e komisionit është caktuar me vendim të zyrtarit kryesor administrativ;
- Në gjashtë komisione: i. janë shqyrtuar ankesat ndaj vendimeve për mos kualifikim si rezultat i mos përmbushjes së kritereve procedurale dhe ii. janë shqyrtuar ankesat ndaj vendimit për ndarje të mbështetjes financiare, në procesin e përzgjedhjes së përfituesve të mbështetjes financiare;
- Në tri komisione: i. është parandaluar përfshirja e ndonjë anëtari të Komisionit vlerësues (parandalim i konfliktit të interesit) dhe ofruesi i mbështetjes financiare e ka paraparë me vendim edhe një anëtarë rezervë.

Raportimi/Monitorimi i komunave

Monitorimi²⁸

Në këtë fushë monitoruesit janë udhëzuar të sigurojnë të dhëna nga raporti vjetor dhe nga tabelat sipas f20 në bazën e të dhënave. Treguesit e monitoruar këtu përfshijnë: rregullsinë e shpenzimit të fondeve publike, monitorimin e realizimit të aktiviteteve të projektit dhe projektit në përgjithësi, rezultatet e arritura përmes zbatimit të projektit, ndikimet e projektit, vizitat në teren dhe vlerësimin periodik të projekteve.

Nga të dhënat del se treguesit e mësipërm (përfshirë treguesit mbi vlerësimin periodik) janë monitoruar vetëm në tri komuna për 16 komunat e tjera nuk ka të dhëna.

Procesi i monitorimit dhe raportimit

Mbledhja dhe administrimi i të dhënave²⁹

²⁷ Neni 9 (1 -5)

²⁸ Neni 2 (2.1 – 2.4), Neni 3 (3.1 – 3.3)

²⁹ Neni 25 (1 -2)

Për këtë fushë të dhënat janë siguruar përmes raportit vjetor e kur ky raport ka munguar atëherë përmes formës f20 në bazën e të dhënave dhe raportit gjithëpërfshirës vjetorë. Vlen të përmendet se ka mungesë të raporteve vjetore. Nga të dhënat në platformën OJQ financime sipas planit vjetor të financimit del se vetëm 19 komuna kanë paraqitur të dhëna për financim;

Treguesit e monitoruar në këtë fushë përfshijnë: mbledhjen dhe administrimin e të dhënave gjatë zbatimit të projekteve, raportimin e përfituesve sipas formatit të përcaktuar në rregullore dhe manual, përgatitjen e raportit përmbledhës të financimit nga ofruesi i mbështetjes financiare, publikimi i raportit në ueb faqe, raportimi në ZQM dhe publikimin në platformën OJQ financime.

Nga të dhënat e monitorimit në 19 komuna që kanë planifikuar financim monitoruesit kanë gjetur se:

- Vetëm në tri komuna janë gjetur të dhëna të mbledhura dhe administruara për mbështetjen financiare publike, gjatë gjithë kohës së zbatimit të projekteve/propozimeve;
- Pesë komuna kanë ndjekur formatin e përcaktuar në Rregullore dhe Manual;
- Në katër komuna është raportuar se është hartuar raporti përmbledhës sa i përket projekteve/programeve të financuara nga burimet publike të financimit;
- Në asnjë ueb-faqe të komunave nuk është bërë publike raport përmbledhës sa i përket projekteve/programeve të financuara nga burimet publike të financimit;
- 17 komuna kanë raportuar në ZQM ku edhe janë publikuar në Platformën e financimit të OJQ-ve.

Formulari dhe përmbajtja e raportit³⁰

Edhe për këtë fushë fillimisht janë kontrolluar ueb faqet e komunave për të parë nëse është publikuar raporti e në rastet kur ky ka munguar, është përdorë formulari nga tabela e bazës së të dhënave sipas f20.

Të dhënat për këta tregues të vlerësuar në këtë fushë tregojnë se dhjetë nga 16 komuna (në tri komuna nuk janë gjetur të dhëna) kanë zbatuar së paku shtatë indikatorë. Tabela në vijim tregon indikatorët e monitoruar dhe nr. e komunave që i kanë zbatuar ato.

Indikatorët që vlerësojnë informacionet e raportuara për projektet/programet e mbështetura me fonde publike	Nr. i komunave që i kanë zbatuar indikatorët
Emërtimin e projektit/programit apo aktiviteteve të financuara	10
Fushat e përgjithshme dhe specifike të financimit	10
Emrin e ofruesit të mbështetjes financiare publike, duke përfshirë programet specifike në kuadër të të cilave ofrohet mbështetja financiare publike	9
Emrin e plotë të përfituesve të mbështetjes financiare, duke përfshirë të dhënat tjera të përfituesit, adresën, numrin e regjistrimit, numrin fiskal dhe të dhënat për personin përgjegjës të OJQ-së	9
Shumën e dhënë për financimin e projektit/programit	9
Të dhënat gjeografike sa i përket vendit të implementimit të projektit	9

³⁰ Neni 2 (2.1 – 2.12)

Thirrjen publike përmes të cilës është ofruar mbështetja financiare	8
Kohëzgjatjen e projektit dhe statusin e zbatimit të tij	7
Raportimi a është bërë sipas formularit përkatës, i cili duhet të plotësohet nga secili ofrues i mbështetjes financiare publike	7
Mënyrën e alokimit të mbështetjes financiare publike	6
Përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë	6
Numrin e përafërt të personave që kanë përfituar apo janë punësuar në kuadër të projekti/programit	6
Aktivitetet kryesore të realizuara në kuadër të projektit	4

Koordinimi dhe Raportimi në mes Komunave dhe Zyrës për Qeverisjes të Mirë

Nga të dhënat në platformën OJQfinancime³¹ e Zyrës për Qeverisjes të Mirë kemi ndarë katër nivele të vlerësimit në performancën e komunave.

Niveli i Raportimit	E gjetura
Publikimi i thirrjeve nga komunat ne OJQ financime	Të dhënat tregojnë: se vetëm 5 nga 38 komuna kanë publikuar thirrjet në OJQ financime deri në vitin 2020, por që është ndërprerë nga ky vit. Publikimi në OJQfinancime do të ndihmonte në kërkime dhe monitorimin më të lehtë të proceseve të financimit.
Planifikimi i financimit	Në planifikimin e financimit për vitin 2022 në platformën OJQ financime, vetëm 19 nga 38 komuna, kanë paraqitur këtë planifikim.
Tabelat e të dhënave/raporti i hollësishëm	Në bazën e të dhënave, raportet e hollësishme të financimit, kanë paraqitur, 26 nga 38 komuna.
Raportimi gjithëpërfshirës	Në raportin gjithëpërfshirës vjetor 2022, nga 38 komuna, 31 kanë raportuar.

Informatat e pranuar nga Zyrat për Informim

Përgjigjet nga 15 Zyrat për informim	Përqindja
Kanë pasur thirrje publike	(87%)
Kanë publikuar vendimet për themelimin e komisionit vlerësues	61%
Janë përgjigjur se kanë publikuar vendimin për themelimin e komisionit të ankesave	7%

³¹ <http://ojqfinancime.rks-gov.net/>

Komunat që kanë kthyer përgjigje kanë deklaruar se nuk janë të publikuara procesverbalet nga komisioni vlerësues dhe i ankesave	0%
Kanë publikuar rezultatet preliminare dhe përfundimtare	23%
Kanë publikuar vetëm rezultatet përfundimtare	53%
Kanë publikuar kontratat me përfituesit	7%
Kanë publikuar raportin final të financimit të OJQ-ve dhe në një komunë nuk hapet linku	20%

Të gjeturat e auditorit 2022 (subvencionet e OJQ-ve)

Referuar Raportit të Performancës të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2022³², te rezultatet dhe adresimi i rekomandimeve të auditimit (financiar dhe të pajtueshmërisë), te kategoria 'Subvencionet dhe Transferet' vihet në pah:

1. Mos përgatitja e planit vjetor për mbështetje financiare, subvencionimi, thirrja publike dhe monitorimi i subvencioneve në kundërshtim me rregulloren;
2. Subvencionimi i OJQ-ve pa thirrje publike;
3. Vonesa në arsyetimin e subvencioneve dhe mos raportim nga përfituesit; dhe
4. Mangësi në procesin e vlerësimit të subvencioneve.

³² https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2023/05/ZKA_RVP_2022_Shqip-1.pdf

Theksi i Auditimit (Kategoria e subvencione dhe transfere) – Raporti i Auditimit 2022	Veprimet e planifikuara për realizimin e rekomandimeve	Komentet
Subvencionimi pa thirrje publike ³³		
<p>Komuna kishte bërë keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë 672,897. Nga kjo vlerë Thesari kishte paguar sipas vendimit përmbartimor të gjykatës për paga jubilarë dhe shujta për arsimtar nga kategori investimet kapitale 401,980 nga kategoria mallra dhe shërbime 67,809, dhe subvencione dhe transfere 109,524. Po ashtu, nga kategoria investime kapitale komuna kishte paguar 93,584, që për nga natyrë i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime.</p> <p>- Kjo kishte ndodhur për shkak të planifikimit jo të mirë buxhetor dhe mungesës së mjeteve në kategoritë adekuate³⁴.</p>	<p>Keqklasifikimi i shpenzimeve ka ndodhur kryesisht për shkak të kontratës kolektive të nënshkruar nga niveli qendror. Ministria e Financave në qarkoren buxhetore në bazë të së cilës komuna e cila planifikon buxhetin nuk ka paraparë mjete buxhetore në kategorinë e pagave për përmbushjen e kontratës kolektive dhe rrjedhimisht nuk ka mundësi t'i planifikojë³⁵.</p>	
<p>Në pesë raste të përfituesve të subvencioneve sipas thirrjes publike për OJQ, komisioni i vlerësimit, përveç që nuk ka ofruar dëshmi të shkruara në lidhje me vlerësimin e aplikacioneve, nuk ka mbajtur as procesverbale për ta kuptuar se si ka ardhur deri te përzgjedhja e përfituesve të subvencioneve nga Komuna. Përveç kësaj, shpallja publike për OJQ nga drejtoria për rini, kulturë dhe sporte, ishte bërë me datën 12.05.2022 deri më datën 25.05.2022, për 13 ditë kalendarike apo dy ditë më pak se rregullat e lejueshme³⁶.</p>	<p>Rekomandimi nga Auditimi Social do të fillojë të zbatohet për të gjitha shpalljet e ardhshme, pra për çdo proces të vlerësimit të shpalljeve, do të ruhen dëshmitë përkatëse (formularët e vlerësimit) të cilat do të nënshkruhen nga anëtarët e komisioneve dhe formularët e vlerësimit do të ruhen si dosje e procedurës së shpalljes. Sa i përket afateve kohore ato do të respektohen sipas rregulloreve përkatëse³⁷.</p>	-

³³ https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2023/06/RaportiAuditimit_K_OB_2022_Shqip-1.pdf

³⁴ https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2023/06/RaportiAuditimit_K_PO_2022_Shqip.pdf

³⁵ https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2023/10/Komuna-e-Podujev%C3%ABs_Plani-i-Veprimit_2022.pdf

³⁶ https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2023/06/RaportiAuditimit_K_SU_2022_Shqip.pdf

³⁷ https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2023/10/Komuna-e-Suharek%C3%ABs_Plani-i-Veprimit_2022.pdf

<p>Dy pagesa për shpenzime të varrimit (6,440 dhe 5,750) ishin paguar nga kategoria mallra dhe shërbime, këto shpenzime për nga natyra i takojnë kategorisë së subvencioneve dhe transfereve³⁸.</p>	<p>Do të ndermirën të gjitha masat që obligimet e mbetura të procedohen me kohë me qëllim të shmangies së procedurave përbarimore e cila po ndikon në keq klasifikim të pagesave në sistem. Gjithashtu, do të respektohen procedurat e shpenzimeve duke bërë pagesat sipas kategorive adekuate dhe kodeve ekonomike³⁹.</p>	<p>-</p>
<p>Gjatë vitit 2022, Komuna kishte paguar 44,300 në emër të pagesave për vendime gjyqësore për kategorinë ekonomike Paga-arsim, duke shfrytëzuar mjetet nga kategoria "Subvencione dhe Transfereve"⁴⁰.</p>		
<p>Sipas nenit 38 të Rregullores MF-Nr. 01/2019 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, udhëheqësi përcakton ndarjen e detyrave që ndanë operacionet dhe përgjegjësitë për zbatimin e dy ose më shumë fazave të një procesi ose aktiviteti në mes të punëtorëve të ndryshëm. I njëjti punëtorë nuk mund të jetë përgjegjës njëkohësisht për miratim, zbatim, kontabilitet dhe kontroll. Në komisionin e vlerësimit të aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për klubet dhe shoqata sportive dhe OJQ për vitin 2022, një anëtar i komisionit përbëhej nga zyrtari certifikues⁴¹.</p>		
<p>Komuna kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve në vlerë prej 9,870 pasi që shërbimet e varrimit ishin paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, ndërsa ishte dashur që pagesa të bëhet nga kategoria e subvencioneve. - Kjo kishte ndodhur për shkak hyrjes në obligime financiare pa pasur mjete buxhetore të planifikuara dhe mangësive në menaxhimin e obligimeve⁴².</p>		
<p>Gjatë ekzaminimit të procedurave për subvencionim, është konstatuar se përzgjedhja e përfituesve ishte bërë pa një metodologji të qartë ndërmjet</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se njoftimet për dhënie të subvencioneve, të jenë të planifikuara, duke siguruar paraprakisht fondet e mjaftueshme, dhe që</p>	<p>E përmbushur. Tani e tutje janë shtuar kriteret në thirrjet për aplikim të fermerëve të</p>

³⁸ https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2023/06/RaportiAuditimit_K_MAL_2022_Shqip.pdf

³⁹ https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2023/10/Komuna-e-Malishev%C3%ABs_Plani-i-Veprimit_2022.pdf

⁴⁰ https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2023/06/RaportiAuditimit_K_DRG_2022_Shqip.pdf

⁴¹ https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2023/06/RaportiAuditimit_K_RAH_2022_Shqip.pdf

⁴² https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2023/06/RaportiAuditimit_K_SHT_2022_Shqip.pdf

<p>aplikuesve të përgjegjshëm, ku edhe pse kishin plotësuar kriteret e vendosura të njëjtit nuk kishin arrit të kualifikoheshin si përfitues⁴³.</p>	<p>njëkohësisht vlerësimi dhe përzgjedhja e përfituesve të bëhet në mënyrë transparente duke mos diskriminuar asnjë aplikues⁴⁴.</p>	<p>cilat tregojnë se cilët fermer do të kenë përparësi për të përfituar⁴⁵.</p>
<p>Komuna kishte bërë keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike, në dy raste janë bërë pagesa në vlerë 17,800€ nga kategoria mallra dhe shërbime të cilat për nga natyra janë subvencione dhe transfere.</p> <p>- Kjo ka ndodhur si rezultat i ekzekutimit të pagesave nga ana e Thesarit për vendimet e gjykatave, për pagesat e pagave dhe shpërblimeve tjera të arsimitareve të cilat janë të përcaktuara me kontratën kolektive.</p> <p>Derisa, në rastin tjetër ka pasur mungesë të mjeteve në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve⁴⁶.</p>	<p>Komunikimi i me departamentin e çështjeve ligjore në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, për përcaktimin e kategorisë së saktë të shpenzimeve për respektimin e Rregullores 01/2013.⁴⁷</p>	<p>Ka raste kur pagesat e procedurës përbarimore dhe vendimet e gjykatave, janë ekzekutues nga zyrtaret e thesarit pa aprovimin e tonë si Organizatë Buxhetore.⁴⁸</p>
<p>Komuna tek financimi i projektit Mbështetja financiare për klubin e futbollit, përmes vendimit në asamblenë komunale kishte lejuar mjete financiare në vlerë 55,000 duke mos zbatuar procedurat e përcaktuara në rregulloren për financimin e OJQ-ve, si thirrje publike për financim të OJQ-ve, trajnimi i barabartë dhe mos-diskriminimi i aplikuesve si dhe gjithë-përfshirja gjinore e përfituesve.</p> <p>-Ky veprim kishte ndodhur si shkas i neglizhencës dhe planifikimit jo adekuat të financimit në projektet e OJQ-ve⁴⁹.</p>	<p>Takimi i ZKF-së me drejtorët që ndajnë subvencione dhe zbatimi i procedurave të Rregullores për financimin publik të OJQ-ve.</p>	<p>17.06.2023</p>
<p>Në tre proceset të subvencionimit të OJQ-ve, anëtarët e komisionit nuk kanë përdorur formularët standard të vlerësimit të kërkesave për financim, dhe se komisioni i vlerësimit të kërkesave për financim, dhe se komisioni i vlerësimit të kërkesave ishte i përbërë me vetëm tre anëtar⁵⁰.</p>		

⁴³ https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2023/05/RaportiAuditimit_K_FE_2022_Shqip.pdf

⁴⁴ https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2023/10/Komuna-e-Ferizajt_Plani-i-Veprimit_2022.pdf

⁴⁵ https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2023/10/Komuna-e-Ferizajt_Plani-i-Veprimit_2022.pdf

⁴⁶ https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2023/06/RaportiAuditimit_K_IST_2022_Shqip-1.pdf

⁴⁷ https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2023/10/Komuna-e-Istogut_Plani-i-Veprimit_2022.pdf

⁴⁸ Po aty

⁴⁹ https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2023/06/RaportiAuditimit_K_FK_2022_Shqip.pdf

⁵⁰ https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2023/05/RaportiAuditimit_K_HE_2022_Shqip.pdf

Konkluzionet

Të përgjithshme	Të ndërthurura	Specifike
<p>Nga plani vjetor i financimit del se gjysma e komunave të monitoruara nuk kanë paraqitur planifikimin e financimit në Zyrën e Qeverisjes së Mirë, përkatësisht platformën OJQfinancime. Ndërkaq, përjashtuar katër komunat veriore, komunat Shtërpçë, Ranillug, Partesh, Kllokot, Mamushë, Deçan, Junik dhe Hani i Elezit nuk kanë pasur thirrje. Kjo tregon se komunat përveç se nuk paraqesin planin vjetor në ueb faqe, ato edhe nuk raportojnë në platformën OJQ financime.</p>	<p>Në ueb faqet e komunave ka vështirësi në gjetjen e të dhënave për financimin publik të OJQ-ve. E njëjta vlen edhe për planet, dokumentet, raportet dhe vendimet në këtë fushë.</p>	<p>Në fushën e shpalljes së thirrjeve, përfshirë udhëzimet, formularët, afatet dhe mënyrën e aplikimit përgjithësisht është arritur progres i konsiderueshëm. Përjashtim bëjnë këta dy indikatorë: 1. qasja në platformat elektronike/e-mail, në veçanti mundësitë për sqarime shitesë dhe 2. publikimi i përgjigjeve në ueb faqet e komunave.</p>
<p>Konsultimet publike në procesin e planifikimit me OJQ apo grupet e interesit në procesin e planifikimit mbesin të mangëta. Vetëm 12 nga 21 komuna që kanë paraqitur të dhëna nga konsultimet publike për dëgjimet buxhetore të evidentuara në raportin e Proceseve Buxhetore në komuna për vitin 2022, kanë mbajtur takime të veçanta me OJQ-të apo grupet e interesit (sportistë, artistë, të rinj, rrjetet e grave, HANDIKOS, Kryqi i Kuq, pensionistët, etj).</p>	<p>Përveç manualit për zbatim dhe formularëve për raportim nuk është hasur në ndonjë udhëzues apo broshurë për vizibilitet të financuar nga komunat.</p>	<p>Tek përmbajtja e udhëzimeve për aplikantët mangësi evidentohen në tri elemente: i. mungesa e ndërlidhjes së objektivave të thirrjes me dokumentet strategjike komunale, ii. problematike del të jenë shumat minimale dhe maksimale të financimit bashkë me numrin e përafërt të projekteve të financuara dhe iii. mungesa e qartësisë në procedurat e monitorimit dhe raportimit të projektit.</p>
<p>Në platformën OJQ financime deri në vitin 2020, janë paraqitur disa thirrjet publike të komunave, nga kjo periudhe nuk ka publikime. Evidentohen mos-përputhje të planifikimit, financimit dhe raportimit të komunave të paraqitura në Planin Vjetor, Raportin dhe Bazën e të Dhënave me Proceset në Komuna.</p>	<p>Komunat vazhdojnë të mbajnë komunikim me palët për procesin e thirrjes dhe aplikimit vetëm fizikisht nëpërmjet Zyrave Pritëse në Komuna, por që përgjigjet në pyetjet në formë elektronike nuk kthehen. Kjo vërehet prej pyetjeve/përgjigjeve për procesin e deri te dorëzimi i aplikacioneve, kontraktimi dhe monitorimi.</p>	<p>Te respektimi i kriterëve të thirrjes publike dhe dokumentet e kërkuara ekziston progres, nisur nga udhëzimet, formularët, lista e dokumenteve të kërkuara. Megjithatë adaptimi i udhëzuesve nga thirrjet në/dhe mes komunave shpesh nuk i përgjigjet thirrjes përkatëse.</p>

<p>Është evidentuar shmangie nga obligimi që njëri nga përfaqësuesit në Komisionin Vlerësues të jetë nga OJQ-të dhe kjo përgjithësisht po zëvendësohet me përfaqësues nga shoqëria civile që nuk janë pjesë e OJQ-ve.</p>	<p>Ekziston një mungesë e paraqitjes tabelare (raporti i hollësishëm) në mes formularit për raportim 20 (f20) dhe tabelës për detajet e financimit të OJQ-ve në bazën e të dhënave.</p>	<p>Sa i përket mënyrës së aplikimit del se komunat nuk kanë platforma elektronike apo edhe regjistra elektronik të aplikimeve. Kjo gjetje ndërlihet direkt me kërkesat e auditorit për regjistrat e kërkesave.</p>
<p>Evidentohet mungesë e kapaciteteve dhe praktikave të komunave për zbatim të procesit të financimit publik të OJQ-ve. Në veçanti, në procesin e planifikimit dhe ndërlidhjes së thirrjeve me objektivat komunale</p>	<p>Nuk është hasur ndonjë praktikë e konsoliduar (caktimi i zyrtarit për mbështetje teknike), ku komunat direkt apo nëpërmjet organizatave kanë ofruar përkrahje teknike për aplikim, në veçanti për organizatat përfaqësuese për grupet e marginalizuara.</p>	<p>Sa i përket vlerësimit të aplikacioneve nga aspekti procedural në mungesë të të dhënave është monitoruar nëse vlerësimi i aplikacioneve është bërë brenda pesë ditëve nga data e mbylljes dhe publikimit të listës preliminare. Mund të konstatohet se ky afat përgjithësisht nuk zbatohet.</p>
<p>Puna me OJQ-të monitoruese, mund të konstatohet se edhe niveli i kërkesës për monitorim dhe llogaridhënie nga procesi mbetet i mangët.</p>	<p>Përjashtim bëjnë rastet kur projektet janë të bashkë-financuara edhe nga donatorët.</p>	
<p>Ekziston një kategori e subvencionimit për OJQ-të që në planifikim trajtohen si financimin por që në fakt nuk do të duhej të trajtoheshin kështu meqë kanë karakteristika të veçanta. Të tilla janë pagesat e shpenzimeve specifike, financimi i aktiviteteve për grupe apo kategori të veçanta sikurse ato që ofrojnë shërbime sociale për grupet e marginalizuara dhe pagesa të shpenzimeve të ceremonive fetare, anëtarësitë në asociacione dhe agjenci zhvillimore.</p>	<p>Evidentohet publikim i rezultateve të projekteve të financuara vetëm me numra të protokollit me arsyetimin e ruajtjes së të dhënave personale.</p>	<p>Në aspektin përmbajtjesorë, në mungesë të procesverbaleve të publikuara të Komisioneve Vlerësuese janë përdorur të dhëna sekondare duke krahasuar listat preliminare dhe përfundimtare për të nxjerrë në pah tri çështje: i. poentimin deri në 100 pikë, ii. diskualifikimin për aplikantët me më pak se 50 pikë dhe iii. Listën e renditur sipas pikëve. Këto informata zakonisht nuk publikohen në thirrje.</p>
<p>Monitorimi i procesit të financimit publik në komuna është zbatohen kërkesat ligjore, rrjedhimisht të dhënat për financim publik janë vështirë të qasshme deri në të pa qasshme.</p>		<p>Sa i përket afateve dhe procedurave të shqyrtimit të ankesave në mungesë të procesverbaleve të publikuara, monitoruesit nuk kanë arritur të sigurojnë të dhëna për fushat përkatëse. Megjithatë, nëpërmjet të dhënave sekondare, krahasimit në mes të listave preliminare dhe përfundimtare është evidentuar se: 1. përgjithësisht në listën preliminare njoftohet për mundësinë e ankesave dhe 2. në listat përfundimtare nuk paraqitet ndonjë e</p>

		dhënë e specifikuar për formën dhe arsyen e vendimit të marrë.
Është vërejtur dallim te thirrjet e menaxhuara vetëm nga Komunitet me ato të bashkë-menaxhuara sidomos me partnerët ku te këto të fundit në masën më të madhe obligimet nga Manuali dhe Rregullorja rezultojnë të përmbushura.		Në mungesë të publikimit të kontratave me përfituesit monitorimi për obligimet e kontratës ka qenë i pamundur. Megjithatë nga të dhënat e përmbledhura në bazën e të dhënave janë marrë parasysh dy të dhëna tabelare: statusi i zbatimit dhe vërejtjet. Përgjithësisht nga vrojtimi del se tek statusi i zbatimit referenca është sipas kontratës pa ndonjë të dhënë specifike, ndërkaq tek vërejtjet nuk është hasur ndonjë shënim.
Në mungesë të raporteve monitorimit të projekteve të financuara nga komunitet nuk ka informata mbi rrjedhën e procesit të zbatimit të projekteve. Po ashtu, edhe mungesa e publikimit të kontratave të financimit të OJQ-ve pamundëson verifikimin e obligimeve karshi zbatimit.		Në mungesë të raportit vjetor dhe paraqitjes në udhëzues apo lista të monitoruesve përgjegjës, kjo e dhënë ka qenë e pa mundur të sigurohet. Ngjashëm, edhe periudhat, shkeljet dhe raportimet. Megjithatë, ngjashëm sikurse tek konkluzioni paraprak, nuk gjenden shënime as në raportin e hollësishëm nga baza e të dhënave.
		Të identifikohen mangësitë në planifikim, në fokus ndërlidhja e fushave dhe objektivave të thirrjes me dokumentet dhe strategjitë komunale (rekomandim nga ZKA).
		Të konsiderohet mungesa e kapaciteteve dhe praktikave të ofruesve të mbështetjes financiare për të ofruar përkrahje teknike për OJQ-të, monitorim dhe vizibilitet (rekomandim nga ZKA).
		Të konsiderohen problemet e OJQ-ve në operim të pagesave (parimi aktual) të aktiviteteve, si rezultat i pagesave pas kryerjes së shërbimit (rekomandim nga ZKA).

Rekomandimet

Të përgjithshme	Të ndërthurura	Specifike
Duhet të përmirësohet procesi i planifikimit të financimeve publike të OJQ-ve duke përfshirë edhe konsultimin. Rekomandohet që komunat të ndërtojnë platforma ose forume të konsultimit.	Të konsultohet Zyra Kombëtar e Auditimit (ZKA) për të ndërtuar platforma dhe regjistra elektronikë të aplikimit të OJQ-ve, po ashtu, në ndryshimin e rregullores për financim publik të OJQ-ve, e paraprirë nga koncepti dokumenti për Fushën e Menaxhimit të Financave Publik ⁵¹ . Kjo sepse komunat marrin komente nga ZKA për protokollet e regjistrimit.	Të avancohet komunikimi përmes platformave elektronike e-mail në procesin e thirrjeve publike, në veçanti të ofrohen sqarime të nevojshme gjatë aplikimit.
Rekomandojmë që të përfshihen të gjitha thirrjet në platformën OJQfinancime dhe të krijohet seksion i veçantë brenda ueb faqeve të komunave apo njësive përkatëse të mbështetjes financiare.	Të përmirësohet vizibiliteti në financimin komunal, duke hartuar udhëzues dhe shpërndarë ata me OJQ-të.	Të përmirësohen kapacitetet e zyrtarëve komunalë për të ofruar udhëzime të qarta të përshtatura me natyrën e thirrjes dhe kontekstin.
Komunat përveç ndarjes së shumave për financim duhet të adresojnë edhe procesin e ngritjes së kapaciteteve të OJQ-ve lokale. Po ashtu, OJQ-të duhet të përfshihen në ndërtimin e platformave dhe agjendave të përbashkëta nisur nga hapësirat e punës, përkrahja teknike dhe logjistike e deri tek përfshirja në proceset e bashkë-krijimit të politikave lokale.	Të shtohen tabelat në mes raportit të hollësishëm sipas formularit fzo ku mund të gjenden të dhëna lidhur me procesin e zbatimit dhe monitorimit të projekteve të financuara.	Të përmirësohet procesi i ndërlidhjes së thirrjeve me dokumentet strategjike komunale, të shmangen praktikat aktuale të shkurtimit të fondeve pa ri-programuar objektivat e aplikimit, të qartësohet në fazën e hershme procesi i monitorimit dhe raportimit.
Në procesin e ndryshimit të legjislacionit dhe rregullativës, rekomandohet që të definohen OJQ-të ku komunat kanë anëtarësi, ato që ofrojnë shërbime për nevojat e komunave	Të aftësohen zyrtarët komunalë për të ofruar ndihmë teknike në procesin e aplikimit në veçanti për organizatat përfaqësuese të grupeve të marginalizuara.	Në procesin e vlerësimit procedural dhe përmbajtjesor, duhet të krijohet forma dhe procedura standarde për të siguruar proces të barabartë dhe pamundësi të favorizimit.

⁵¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=66005>

dhe entitetet specifike (Bashkësitë Fetare) që operojnë me/dhe në komuna.		
Komunat duhet të ndërtojnë një kornizë të dokumenteve që lidhen me procesin e transparencës dhe llogaridhënies në financimin publik të OJQ-ve, përfshirë edhe krijimin e një seksioni të veçantë në ueb faqe.	Rekomandohet të definohet publikimi i të dhënave, duke marrë parasysh obligimet për transparencë, llogaridhënie dhe mbrojtjen e të dhënave personale.	T'u shtohet listave preliminare dhe përfundimtare poentimi deri në 100 pikë, diskualifikimi deri në 50 pikë dhe lista e plotë e renditur sipas pikëve.
Komunat duhet të adaptojnë praktikat e mira nga bashkë-financimet dhe menaxhimi i procesit të financimit nga organizatat dhe donatorët.		Duhet të rritet ndjeshëm transparenca në vlerësimin e ankesave dhe përgjithësisht të definohet cikli nga aplikimi deri tek shpallja e listave përfundimtare.
Duhet të përmirësohet procesi i raportimit nga komunat, publikimit të raporteve në komuna dhe raportit përmbledhës vjetor.		Të ndërtohet një kornizë e qartë e raportimit që përmbledhë të dhënat e kërkuara sipas udhëzimit administrativ dhe manualit. Po ashtu, rekomandohet që komunat të hartojnë metodologji për të matur rezultatet e arritura nga thirrja publike.
Duhet të përmirësohen proceset dhe kapacitetet e monitorimit dhe raportimit në komuna.		Të përkrahen komunat me asistencë profesionale në procesin e planifikimit të financimit të OJQ-ve (rekomandim nga ZKA).
Të rritet transparenca nëpërmes publikimit të kontratave të financimit publik të OJQ-ve.		Të ofrohet përkrahja teknike dhe profesionale e ofruesve të mbështetjes financiare për ngritjen e kapaciteteve dhe praktikave (rekomandim nga ZKA).
Të adresohet financimi i shërbimeve specifike.		Të adresohet problemi i pagesave në procesin e ndryshimit të legjislacionit/rregullativës dhe qartësohet statusi i zbatimit (rekomandim nga ZKA).



**KOSOVO LOCAL
GOVERNMENT
INSTITUTE**

Kosovo Local Government Institute
Address: Str. Egnatia, E-9, FI-3, Nr. 17, 10000
Prishtinë, Republic of Kosovo
Tel: +381 (0) 38 522 000
Mobile: +383 (0) 44 253 835
E-mail: info@klgi-ks.com | web: www.klgi-ks.com